

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Nr. 2004/7, nenit 27 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Kryetari i OEK shpallë këtë:

FTESË PUBLIKE PËR SHËRBIME PROFESIONALE PËR ANGAZHIMIN E NJË EKSPERTI OSE KOMPANIE KONSULENTE PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL TË GJELBËR (Green VET)

Oda Ekonomike e Kosovës, në kuadër të projektit “Shkathhtësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Kosovë”, financuar nga Qeveria e Luksemburgut dhe implementuar nga Agjencia për Zhvillim e Luksemburgut (LuxDev), përmes projektit “Nxitja e Inovacionit dhe Qëndrueshmërisë për Sistemin DUAL të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Kosovë”, bën ftesë për ekspertë individualë/kompani konsulente të aplikojnë për ofrimin e shërbimeve konsulente për hartimin e Strategjisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional të Gjelbër (Green VET)

Qëllimi i këtij angazhimi është zhvillimi i një Strategjie gjithëpërfshirëse Green VET, e cila do të shërbejë si dokument udhëzues për integrimin e parimeve të qëndrueshmërisë, ekonomisë qarkore, efikasitetit të burimeve dhe rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike në të gjitha nivelet e sistemit Dual VET.

Strategjia do të ofrojë një kornizë strategjike dhe praktike për zhvillimin e aftësive të gjelbra, duke kontribuar në përgatitjen e fuqisë punëtore për ekonominë e gjelbër dhe tranzicionin e qëndrueshëm në Kosovë.

Shërbimet përfshijnë:

- Analizimin e gjendjes aktuale të integritetit të komponentëve të gjelbër në sistemin VET;
- Analizën krahasuese (benchmarking) të praktikave më të mira rajonale dhe ndërkombëtare;
- Hartimin e Strategjisë Green VET;
- Zhvillimin e Planit të Veprimit dhe Kornizës për Zbatim dhe Monitorim;
- Organizimin e konsultimeve me palët e interesit dhe finalizimin e dokumentit strategjik.
- Hartimin e treguesve për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë

Konsulenti/kompania do të dorëzojë:

- Planin e punës dhe metodologjinë;
- Raportin mbi analizën e gjendjes aktuale;
- Raportin e analizës krahasuese (benchmarking);
- Draftin e Strategjisë Green VET;
- Raportin nga konsultimet me palët e interesit dhe procesin e validimit;
- Strategjinë përfundimtare Green VET;
- Planin e Veprimit dhe Kornizën për Zbatim dhe Monitorim.

Kërkesat për ofertuesin

- Të kenë së paku 7 vjet përvojë profesionale në zhvillimin e strategjive dhe politikave në fushën e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (VET);
- Të kenë përvojë të dëshmuar në hartimin e strategjive Green VET, integrimin e aftësive të gjelbra ose zhvillimin e kornizave që lidhen me qëndrueshmërinë;
- Të kenë ekspertizë në tranzicionin e gjelbër, ekonominë qarkore ose zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të kenë njohuri mbi sistemin Dual VET dhe politikat relevante evropiane;
- Të kenë përvojë në analizë strategjike dhe benchmarking;
- Të kenë aftësi të shkëlqyera analitike, koordinuese dhe raportuese.

Dokumentacioni i kërkuar

- CV-në e ekspertit ose profilin e kompanisë;
- Ofertën teknike, e cila përfshin metodologjinë e punës dhe planin e angazhimit;
- Ofertën financiare;
- Referenca ose dëshmi të përvojës në projekte të ngjashme.

Kriteri i përzgjedhjes së ofertës fituese:

1. Propozimi teknik 70 %: Metodologjia, Kualifikimi, CV dhe përvoja, referenca
2. Propozimi Financiar 30 % **çmimi më i volitshëm i ofertuar**, duke marrë parasysh përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale.

Ofruesi i shërbimit duhet ta ketë parasysh ky aktivitet do tëzbatohet deri në fund të periudhës **Korrik 2026**, prej **16 ditësh pune të ekspertit**, ndërsa cmimi total i ofertuar duhet të mbulojë të gjitha shërbimet e kërkuara për realizimin e aktivitetit për të gjitha fazat e planifikuara deri në përfundim të projektit, pa kosto shtesë për OEK-un.

Për informata të detajuara mbi angazhimin, aplikantët duhet t'u referohen **Termave të Referencës (ToRs)** që janë pjesë përbërëse e kësaj thirrjeje.

Dokumentet duhet të dërgohen në email: arsimidual@oek-kcc.org, duke shënuar në subjekt: Ofertë për ftesë publike – Hartimi i Strategjisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional të Gjelbër", më së largu deri më 09.07.2026, ora 12:00.

Ftesa publikohet në uebfaqen zyrtare dhe në Facebook-un e Odës Ekonomike të Kosovës.

Lulzim Rafuna

Kryetar

Oda Ekonomike e Kosovës

